

E veçanta e poezisë së Gjekë Marinajt

# Labirinthet e mendimeve të Tanugunit

Mujo BUÇPAPAJ

**G**jakë Marinaj është një poet universal ku dije nia e jetës dhe artit japin bashkë pamjen më të përkyer të krijimtarisë. Ai po sfidon emrat më të medhenj të poezisë bashkëkohore amerikane duke tronditur formalitetin poetik dhe format tradicionale të shkruarit me librin e tij të fundit "Lutje në ditën e tetë të javës".

Marinaj bën atë që nuk e kanë bërë të tjerrë para tij, duke bashkuar imazhe, legjenda, profile dhe filozofi të popujve, racave dhe kombeve me një lehtësi të rrallë që mund ta bëj vetëm një poet që vjen nga Ballkani, vend i poezisë, legjendave dhe miteve.

Marinaj, i cili provokoi në rindin e tij regjimin komunist me poezinë e tij "Kuajt", tani provon bibliotekën e poezisë botërore, pas shumë vuajtjes njerëzore, në fillim si emigrant që ka kaluar telat me gjemba dhe pastaj si student i shkelqyer dhe si pedagog i letërisë bashkohore në Universitetin e Richlandit në Dallas të SHBA-ve.

Marinaj ka eksperimentuar me një guxim të qartë duke ndertuar një kod të ri poetik të sofistikuar, i vlerësuar me shumë çmimë letrare në Amerikë.

E përpunuar në laboratorin e poezisë amerikane, krijimtarja e Gjekë Marinajt është një majë e poezisë bashkohore, ku rifillimi i jetës zhvesh pamjen optimiste të poetit, përendrrës mashtruese, pasi për atë ka gjithnjë një ditë të tetë, e cila mund të quhet dita e lutjes, mallkimit apo lumturisë së poetit.

Marinaj i përgjigjet me dinjitet nevojës për ndryshime në poezinë shqipe, duke sygjeruar një leksion të shkruari përfekt si një "autorportret i avancuar" i stilit të poetit dhe jetës së tij, mes imazhit të Atdheut të braktisur dhe gjykimit për dashurinë e botës së pafundit.

Nëse Walt Whitmani i dha fund imitimit të shkollës europiane të poezisë në Amerikë, duke krijuar vargun i tij biblik, original edhe Marinaj me "Lutje në ditën e tetë javës" ka krijuar një civilizim të ri për poezinë shqipe, duke ndihmuar jo vetëm vendin e tij, por edhe poezinë evropiane.

## AUTOPORTRET I AVANCUAR

Forma e poezisë së Gjekë Marinajt ndryshon nga njëri cikël poetik tek tjetri. Një shpërthim lëndesh universale ringrejnë mendimin shijues të poezisë së Marinajt në stade të reja, të frekuentuara nga motive filozofike dhe shpirti human që e dallon atë nga poetët e tjerë bashkëkohorë amerikan.

Poezia amerikane e shekullit të XXI përbehet nga një radhë poetësh të shquar që ecin në një garë me shumë krosi, pa patur akoma një lider. Siç vëren kritika vendase ndryshe nga Shek. XX kur Amerika lindi një numër të madh poetësh si Wallace Stevens, Ezra Pound, T.S. Eliot (i lindur në Amerikë), William Carlos Williams etj, në shekullin e ri disa nga poetët më të shquar të saj janë amerikanë të natyralizuar, si Ferderik Turner, Eduard H. Gracia, Rainer Schulte etj. Në këtë grup bën pjesë edhe poeti me originë shqiptare

Gjekë Marinaj, i cili me librin "Lutje në ditën e tetë të javës", unifikon sipër botës dashurinë dhe dhimbjen, si një bashkë vuajtjes i vetëdijshëm i planetit.

Libri hapet me ciklin "Mesnatë pa kalendar", i cili është një cikël filozofik i shkruar me një mençuri të skajshme. Është një cikël i sofistikuar, i shkruar për një élite lexuesish. Poezia "Autoportret i avancuar" është një mini-poemë, një esencë e librit. Poezitë në librin "Lutje në ditën e tetë të javës" e ndihmojnë lexuesin të transformojë vizionin, të shqyrtojë vetven dhe të arrijë përfundimet e duhura si jehonë e jetës e shndërruar shpesh në melankoli dhe dyshim. Ky cikël përbën një rifreskim fundamental të poezisë bashkëkohore, me një përkushtim subsencial të poetit, plot çiltërsi metafore dhe shpirt të gjerë komunikimi.

Ky cikël shënon një sfidë jo vetëm në karrierën poetike të Marinajt, por edhe për caqet që vë përparrë poetëve bashkëkohorë amerikanë dhe evropianë. Të krahasuara me një stekë të ngritur lart për garë, ato dallojnë për strukturën, mënyrën e të shprehurit dhe imazhet e kërkuarë mes dashurisë dhe dhimbjes që dalin prej demokracisë së shpirtit të tij dhe përsosjes morale dhe artistike. Poezia e tij ka fituar admirues të spikatur sidomos ata tek ai grupim që është i dhënë pas poezisë filozofike. Ashtu si Gary Snyder, edhe Gjekë Marinaj sjell në poezinë bashkëkohore amerikane dhe shqiptare një prezencë të fuqishme autoriale.

Cikli i dytë "24 orë dashuri", është një cikël i bukur, i shkruar për t'u

kuptuar nga të gjithë. Poezitë janë ndërtuar duke përdorur një formë tradicionale, por një tekst të papërdorur më parë. Për shembull në poezinë "24 orë dashuri" sido e shkruar me një lojë fjalësh, teksti përsos kodet poetike të realizuara shumë dekada më parë nga poeti i shquar shqiptar Lasgush Poradeci.

...

Dhe u largua tinëzisht për ne duke folur uratë,

Natyrsht, natyrsht bëmë dashuri në natyre.

...

Dhe zbuluan buzëqeshjen më të re të universit

Natyrsht, bëmë dashuri në natyre, natyrsht.

...

Dhe zbuluan buzëqeshjen më të re të universit

Natyrsht bëmë dashuri në natyre, natyrsht.

...

Dhe muskujve të tokës u pëshpëriti një sekret

Bëmë dashuri në natyre, natyrsht.



Siç shprehet edhe kritika "në pikëpamje të formës, lirika e Marinajt mbart në vete konceptin e përsosmërisë ritmike, një parjim organizues simetrik, ku gradacioni poetik, aluzionet e vargjeve në përpikëmëri gërshtohen mes përbajtjes dhe formës."

## RRËFIMI I ROZAFËS

Gjekë Marinaj me librin "Lutje në

ditën e tetë të javës" i vë vetës detyra të reja në lidhje më cilësinë e poezisë dhe këtë e ka arritur me një pasion të vërtetë. Dhuntia e imaginatës së gjallë me plot nota prekëse ka bërë që Marinaj të unifikojë konceptet metaforike të duarve të nënës, pamjes së fshatit dhe shpresës së drithës në kodrat përrreth. Cikli "Në duart e nënës" përmbledh poezi për fshatin, vendlindjen, Nënë, poezi për pasuritë dhe varféritetë e fshatit etj. Cikli është ndërtuar për t'u kuptuar nga çdo lexues, i cili do të gjëjë në këto poezi shumë pasazhe drithëruese, meditative. Në këto poezi njeriu qetëson shpirtin përmes imazhesh që lëvizin me lirshmëri, nga observime të pastra, nga skena jashtëzakonisht emocionuese dhe njerëzore. Në këtë cikël poeti ka shkruar me një stil të qartë, që është i përshtatshëm si për auditorin që e ka zgjedhur për t'ju drejtuar, ashtu edhe përvetën e tij si poet i klasit botëror. Risjellja e vlerave humane dhe e zemrës së tij lënë "në duart e nënës" krijojnë një pamje që mund ta zgjojnë vetëm poetë të thelbit poetik si Gjekë Marinaj, i cili ka fituar një famë të merituar në poezinë bashkëkohore Amerikane.

Ashtu si poeti i njohur, bashkohor amerikan Ted Kooser, edhe Marinaj në këtë cikël praktikon një universalizëm të gjuhës poetike të përshtatur për një lexues të thjeshtë, por me intuitë të mprehtë përtë zbuluar vlerat. Kjo është diçka shumë pozitive pasi përmes detajesh konkrete merr një zhvillim abstrakt, por dëshëri përbotshëm metafora e fshatit dhe e Nënës. Poezia e Gjekë Marinajt është e



një niveli jashtëzakonisht të lartë. Krahasuar me dy vëllimet e tjera poetike "Mos më ik larg" (1995) dhe "Infinit" (2000), "Lutje në ditën e tetë të javës" shënon një kapercim të paparë jo vetëm për krimatarinë e tij, por edhe për nivelin e poeziës botërore në përgjithësi, të cilin Gjeka e shkund nga themellet.

Cikli "Rrëfimi i Rozafës", përfshin poezi që Marinaj i ka kushtuar Shkodrës, Kosovës, Rozafës, Nënë Terezës, Skënderbeut etj. Poezitë konceptojnë dashurinë humane, jo erotike. Në këtë koncept ai ka pasqyruar çdo vuajtje nga Nënë Tereza deri tek Rozafa e murosur. Rrëfimi i Rozafës është më originali me këtë temë në poezinë shqipe. Marinaj e sheh Rozafën si Viktimë dhe jo si heroinë.

*Nën iluzionin se një grua vlen më pak se një burrë,  
Më murosën mua.*

...  
*Nën pretekstin se te gjithë patën të drejtë,  
Edhe unë muroso brenda vetës fjalën "vrasje."*

*(Rrëfimi i Rozafës)*

#### SYGJERIM ME ZË TË ULËT

Cikli "Sygjerim me zë të ulët", mbart një trishtim të ndjeshëm, pasi Marinaj ka përfshirë në të poezi që kanë të bëjnë me disfatat njerëzore me humbjet dhe vështirësitë e njeriut në jetën tonë. Ato përcjellin sygjerimin për të përbaluar sfidat e jetës të cilat shpesh bëjnë shkrumb e hi endrrat tona, prej nga na duhet t'ia rinisim nga

e para. Megjithatë, ashtu si tek Maya Angelou një tjetër poete e shquar amerikane, edhe tek Marinaj ndjehet personaliteti human i poetit i cili para se gjithash i drejtohet me tone kritike vvetvetes, duke ndihmuar pastaj lexuesit që të arrijnë në përfundimin e duhur. Marinaj në këtë cikël si një dëshmitar i zotit i bën gjérat të duken edhe nga fundi i dheut. Përmes kontrastit të zymtësisë së pamjes së padëshiruar dhe humbjes, ai mjaftueshëm i ndez një kujtesë njeriut për të mos harruar jehonën vajtuese të atdheut të tij.

Për shembull poezi "Flluska mbi Adriatik" e cila trajton humbjen tragjike të njerëzve në anijen "4 i Radës" me 28 mars 1997 në detin Adriatik, të lë pa frymë. Ata humbën jetën duke mbetur në trajtën e flluskave mbi Adriatik. Në poezi ndjehet kontrasti dyfish i perëndimit si qytetërim, por edhe perëndimit si muzg, si mbrëmje kur ata fatkeqinj u nisën përmes detit në kërkim të lumturisë, ashtu siç ishte nisur vetëm 7-8 vjet më parë poeti Gjekë Marinaj, por vetëm zoti e kishte shpëtar.

*"Perëndimi në të dyja kuptimet e fjalës*

*Gravitet specifik ekstrem,  
Kripë dhe shqiptarë,  
Uji dhe vdekje."*

*(Flluska mbi Adriatik)*

#### AILUROPOJA NË GJYGIN E FJALËS

Në një botë të kërcënuar nga shpërbërja e zjarrit të urrejtjes,

rrënimini tronditës ndalet vetëm nga poetët, thotë Gjekë Marinaj. Ai vëren se gravitet i javës e tërheq poetin në vertikalitetin e intuitës njerëzore gjatë shtatë ditëve, ndërsa të hënën poeti e rifillon përsëri nga e para, e kështu si një mallkim i përjetshëm, duke shënuar ditën e tetë të javës.

Sic ka vërejtur kritika, "ky vëllim poetik që në titull implikon nivelin e leximit intertekstual të poeziës, që këtu nënkupton konteksttin e shtatë ditëve të krimimit biblik. Kjo lojë poetike përvëçse reflekton koncepcionet për krimimin, këtë akt të magjishëm, e sforcon aktin krijues deri në kod kulturologjik universal e të përjetme. Poeti Marinaj i shtron krimimit hyjnor një ditë për vete (dhe krijuesit), nga shtatë ditë të krimimit biblik, ngase kësisoj përbushet plotsia e universit apo "engjëjt të zbresin nga paraja dhe të bëhen poetë", "Lutje në ditën e tetë të javës".

Vokacioni i vuajtjes për racën e poetëve është i pashmangshëm edhe në librin "Lutje në ditën e tetë të javës" e shkruar nga një penë dytehëshe e Marinajt, si vetë jeta e poetëve të mëdhenj që njojin njëkohësisht edhe lavdinë edhe përbuzjen. Ky cikël pasuron me tej shumëlojshmërinë stilistike të "Lutje në ditën e tetë të javës", ku dallon intelekti i një profesori letërsie dhe studiues pasoinant të poeziës botërore si Marinaj.

Cikli "Ailuropoja" në gjyqin e fjalës, u është kushtuar poetëve që kanë jetuar në një realitetë të ndryshme vuajtjesh apo lavdie, si Fishita i mohuar për 50 vjet dhe i ripranguar përsëri, Emili Dikindonin, apo tragizmi i poetit Frederik Reshpja i cili vdiq i vtmuan.

*"Poetit i pati humbur me kohë harmonia e trupit*

*Me ndjenjën. Koordinimi i shpirtit më vargun jo."*

Cili ka poezi interesante si "me Nerudën pranë Atlantikut", poeti shkruan se "sa herë që jep shpirt një poet diçka vdes brenda meje." Apo poezi "Nëna e poetit Luigi Çekaj dha shpirt, siç thotë ai "nëna e cilitdo poeti është nëna e të gjithë poetëve."

"Ailuropoja në gjyqin e fjalës" i është kushtuar poetëve Blloshmi dhe Leka, të pushkatuar nga regjimi komunist.

#### LABIRINTHET E MENDIMEVE TË TANUGUNIT

Këto janë poezi që e trajtojnë botën si pjesë e qenies njerëzore të të gjithë shoqërisë poetike. Cikli fillon me malin e Fuxhit që e pat shkatruar Tokion, prej nga u desh të krijohej një e re, sepse Vullkani mbuloi qytetin.

Një tjetër poezi është për arkitekturën e New Yorkut, ku Marinaj ndjek traditën e shumë poetëve të shquar amerikanë dhe botërore që kanë shkruar për qytetin gjigand.

Një tjetër poezi interesante është Labirinthet e mendimeve të Tanugunit". E bazuar në mitologjinë koreane, Marinaj "na del më specifik se kushdo në komunitetin tonë letrar, i pakrashueshëm me format dhe mënyrën si e organizon materien poetike, si e koncepton temën e si i mishëron varjet me figura dhe sistemin e brendshëm të rimimit dhe ritmit." Në këtë poezi janë marrë kafshë si

tigri, arusha etj., të cilat implikojnë koncepsione universale. Poezitë përcjellin idenë se çfarëdo përpjekje që të bëj njeriu në jetë, n.q.s kanë rezultatin zero, ti nuk ke bërë asgjë. Poezia është kundër famës dhe meritave fallco.

Tjetër poezi interesante është ajo për Kullën "Eifel." Ajo përcjell një mesazh interesant, siç thotë poeti "një peizazh i humbur në përkthim."

\*\*\*

Vëllimi i Gjekë Marinajt shënon një pikë kthëse në poezinë shqipe.

Ajo është një lëndë universale plot trazim shpirtëror, dijesh, kulturash dhe emocioneve të thella. Ato kanë një dendësi artistike, forcë dhe imazhe që shkojnë nga ato të drejtëpërdrejtat deri tek surrealistet. Siç që vlerësuar kritika

"poeti në cilësinë e orakullit evonon me gjuhën e së bukurës dhe sublimes perceptimet për jetën dhe universin. Këto përcimime dhe observime poetike i gjemë të sintetizuara në Ibrin me poezi të Gjekë Marinajt "Lutje në ditën e tetë të javës". Njohuritë e fituara nga studimet e gjata dhe komplekse reflektohen në një eksperiment të suksesshëm letrar, si një bazament i ri shkencor për formën poetike në poezinë bashkëkohore, por edhe si një koncept universal human. Poezia e Marinajt mbart një vjetvete inteligencë, pasion, ndjeshmëri dhe spontanitet.

"Lutje në ditën e tetë të javës" është një dëshmi poetike për njerëzimin e cili ka akoma shumë sfida dhe punë për të bërë, duke mbartur ideale të forta të jetë dhe lirisë.